

# RAPORTI TEKNIK | PROJEKTIT TË PROPOZUAR.

**SUBJEKTI KËRKUES:** "ROZAFÄ" SH.P.K.

**AKTIVITETI:** ZËNIE, GRUMBULLIM, PËRPUNIM DHE TREGTIM ME SHUMICË E  
PAKICË TË PRODHIMEVE TË DETIT, ETJ.

**ADRESA:** GRAMSH, ISH- REPARTI USHTARAK NR. 5012/20, ÇEKREZ



**HARTOI RAPORTIN: LOERMA SH.P.K.**

**Subjekti kërkues "ROZAFÄ" sh.p.k.**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me emër subjekti "ROZAFÄ" sh.p.k. është themeluar me datë 05.01.2006, është regjistruar më datë 05.01.2006 në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB) me numër unik identifikimi të subjektit ( NIPT) K48130547V.

Objekti i veprimtarisë së subjektit "ROZAFÄ" sh.p.k.është: *"Zënie, grumbullim, përpunim dhe tregtim me shumicë e pakicë të prodhimeve të detit, brenda dhe jashtë vendit...etj."*

Administratori i këtij subjekti është znj. Lisiena METOSHI me afat emërimi nga: 02.07.2018 deri 02.07.2023.

Zyrat qendrore të shoqërisë "ROZAFÄ" sh.p.k., janë në adresën Tiranë, Tiranë,TIRANË, Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati 89, Shkalla 2, Ap. Nr. 3, Zona kadastrale 8150.

Subjekti "ROZAFÄ" sh.p.k. ka disa kohë që ka përshtatur ndërtesat e ish-Repartit Ushtarak Nr. 5012/20, në Fshatin Çekrez të Bashkisë Gramsh. Në këto ambiente ushtron veprimtarinë e përpunimit dhe prodhimit të karakleçave të detit, si ushqim të gatshëm.

Subjekti ka kryer investime për rikonstruksionin dhe përshtatjen e godinave, të rrjeteve inxhinjerie, instalimin e makinerive e paisjeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së planifikuar.

**Kuadri ligjor mbi të cilin mbështetemi.**

Ne mendojmë se është e nevojshme të paraqesim një përshkrim të përmbledhur të legjislacionit mjedisor të vendit tonë, i cili do të shërbejë për të ndihmuar subjektin në punën e tij të përditëshme. Njëkohësisht kjo do të pasqyrojë detyrimet e subjektit në raport me këtë legjislacion, veçanërisht gjatë periudhës së kryerjes së investimeve për rikonstruksionin e objektit si dhe gjatë periudhës së shfrytëzimit të tij.

Për hartimin e këtij raporti të V.N.M-së, jemi mbështetur në:

- Ligjin Nr. 10 431 datë. 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" ( i ndryshuar).
- Ligjin Nr. 10448 dt.14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" ( i ndryshuar).
- Ligjin Nr. 10440 dt.07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" ( i ndryshuar).
- Ligjin Nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin"( i ndryshuar).
- Ligjin Nr.10 266, datë 15.04.2010 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- Ligjin Nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" ( i ndryshuar).
- Ligjin Nr. 9774 datë 12.07.2007 "Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis".

- V.K.M. Nr. 99 datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve".
- V.K.M. Nr.418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim".
- V.K.M. Nr. 229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transfekimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionin që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit."
- V.K.M. Nr. 371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme"
- V.K.M. Nr.177, datë 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse".
- V.K.M. Nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit" .
- V.K.M. Nr. 435, datë 12.09.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
- V.K.M. Nr. 352, datë 29.04.2015. "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të".

#### I. Qëllimi i projektit të propozuar.

Veprimtaria që ne vlerësojmë ka të bëjë kryesisht me përpunimin e karkalecit të detit (*Penaeus kerathurus*) i cili njihet edhe me emrat të tjerë si lokati, gamberoni, etj.



Subjekti tashmë ka arritur parametrat e projektit në sasinë e lëndës së parë që përpunon si sasinë ashtu edhe në cilësinë e produktit të prodhuar. Ai ka programe për të përmirësuar treguesit e humbjeve teknologjike si dhe të impakteve në mjedis.

- II. Planimetria e vendndodhjes së projektit, (ku pasqyrohen në hartën topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret për kohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë).

Bashkangjitur ndodhet planimetria e vendndodhjes së godinave ku zhvillohet ky aktivitet.



Veprimtaria e subjektit "ROZAFÄ" sh.p.k.zhvillohet në godinat e ish-Repartit Ushtarak në fshatin Çekrez, Njësia Administrative Kodovjat, Bashkia Gramsh. Këto godina gjenden në anën e majtë të rrugës automobilistike Gramsh – Kodovjat.

Ky objekt është i lidhur me infrastrukturën inxhinjerieke të kësaj zone si dhe me rrjetin rrugor kombëtar.

Objekti përfshihet në koordinatat e pasqyruara në vijim (sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE).

Pikat	X	Y
1	45 23 860.785	44 31 714.065
2	45 23 878.643	44 31 866.888
3	45 23 834.780	44 31 906.993
4	45 50 820.453	44 31 882.803
5	45 23 670.252	44 31 846.307
6	45 23 719.827	44 31 796.466
7	45 23 734.306	44 31 754.626

Kufiri jugor i pronës është ai me rrugën automobilistike Gramsh – Kodovjat. Ndërsa në të tre anët e tjera të horizontit kemi kufizime me tokë arë të mbjella me kulturat bujqësore të zonës dhe me drufrutor si për shembull ullinj, etj.

Në afërsi të objektit nuk gjenden banesa familjare si dhe objekte të linjave teknologjike të prodhimeve të ndryshme, objekte sociale e tregtare.

- III. Informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti.

Trualli mbi të cilin gjenden godinat ku zhvillohet aktiviteti i përpunimit të karkalecit, gjendet në jug-lindje të Qytetit të Gramshit apo në Jug – Perëndim të Fshatit Mashan, dhe pranë bregut të djathtë të Lumit Devoll rreth 90 m larg tij në vijë ajrore.

Ky truall, është pjesë e fshatit Mashan të Njësisë Administrative Kodovjat. Nën administrimin e kësaj njësie administrative bëjnë pjesë fshatrat Kishtë, Çekrezë, Zamshë, Nartë, Bërsnik i Sipërm, Bërsnik i Poshtëm, Pasnovisht, Mashan, Broshtan, Bulçar, Zenelas, Mesenik, Kishtallarë, Shelcan, Gramsh-Fshat, Harunas, Kokël.

Banorët e këtyre fshatrave merren kryesisht me fermat e tyre bujqësore drejtimit i zhvillimit të të cilëve është prodhimi i ushqimit për kafshët shtëpiake, prodhimi i zarzavateve dhe i pemëve frutore. Një pjesë e tyre merren edhe me shfrytëzimin e pyllit të punësuar në subjekte të liçensuar për menaxhimin e pyjeve e kullotave. Ndërtimi i kompleksit energjitik mbi lumin Devoll, ka bërë që banorë të këtyre fshatrave të punojnë për ndërtimin e këtyre veprave energjitike.

Pozicioni i parashikuar përmbush kushtet më të domosdoshme për zhvillimin e këtij aktiviteti. Një ndër arsytet më të rëndësishme është pozicioni i veprimtarisë në një zonë me sipërfaqe të konsiderueshme, largësia nga qendrat e banuara, infrastrukturë egzistuese inxhinjrike për furnizimin me energji elektrike, ujë, lidhje me rrugë automobilistike, etj.

Zhvillimi i këtij projekti ka krijuar mundësi të hapjes së vendeve të reja të punës, në këtë zonë rurale me kërkesa për zhvillim dhe mirëqënie. Kështu, janë krijuar ambiente të përshtatëshme me kushte optimale që punonjësit të kryejnë proceset e përpunimit dhe paketimit të produkteve të detit.

- IV. Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektit, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit.

Bashkëngjitur keni fletë të projektit teknologjik, të operimit të venddepozitimit të mbetjeve urbane së bashku me disa fletë të projektit ndërtimor, si dhe skica e planimetria e objektit.

- V. Përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit.

5.1. Përshkrimi i proceseve ndërtimore.

Në kohën e kryerjes së vizitës njohëse në objekt, ekspertët konstatuan se kanë përfunduar pothuajse tërësisht punimet ndërtimore:


- a. Për rikonstrukcionin e objekteve kryesore duke i përshtatur ato për veprimtarinë që do të kryhet. Në godinën kryesore ku zhvillohet ky aktivitet janë ndërtuar ambjentet hidro-sanitare të reja.
- b. Për sistemimin e të gjithë territorit të pazënë me ndërtime, për ta përshtatur atë me operacionet e punës të lidhura me këtë veprimtari.
- c. Për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve, pusetave, etj. për mbledhjen dhe sistemimin e ujërave sipërfaqësorë. Pjesë e tij është edhe kolektori kryesor që do shkarkojë këto ujëra në lumin Devoll i cili rrjedh në kufirin jugor të objektit.
- d. Për rikonstrukcionin e rrugëve të brendëshme të nevojshme për qarkullimin e mjeteve të transportit në shërbim të kësaj veprimtarie.
- e. Për ndërtimin e murit/gardhit rrethues në kufinj të truallit, për të penguar hyrjet e pakontrolluara të personave që nuk punojnë këtu, si dhe të kafshëve të egra e të buta të zonës.
- f. Për ndërtimin e vaskës së dekantimit, në të cilën kalojnë të gjitha ujrät që dalin gjatë pastrimit të ambjenteve të punës, para shkarkimit të tyre në lumin Devoll.

Përgatitja e projekteve teknologjike, ndërtimore si dhe projektet e infrastrukturës inxhinjrike janë hartuar nga një subjekt i licencuar në fushën e ndërtimeve.

5.2. Përshkrimi i proçeseve teknologjike.

Proçesi teknologjik konsiston në përpunimin e karkalecave të detit (*Penaeus kerathurus*), deri në produkt të gatshëm për treg. Në vijim po tregojmë skemën teknologjike.

SKEMA TEKNOLOGJIKE E PËRPUNIMIT TË KARKALECIT TË DETIT.



Lënda e parë, karkalecat e detit (*Penaeus kerathurus*) vijnë në këtë objekt nga qyteti i Elbasanit, qendra e veprimtarisë së këtij subjekti. Karkalecat e detit vijnë zakonisht të ngrirë. Drejtuesi teknik i prodhimit, pas shkarkimit nga automjeti i transportit, organizon dhe drejton punën për shkrirjen e tyre.

### ***Proçesi i shkrirjes.***

Karkalecavetë detit u hiqet ambalazhi dhe vendosen në kosha plastikë dhe mbi to hidhet ujë i ngrohtë në sasi relativisht të mëdha. Pasi realizohet shkrirja, karkalecat e detit, në sasi të përcaktuara futen në kosha plastikë të përshtatshëm për kullimin e ujit dhe për transportin e tyre, në sektorin ku bëhet pastrimi.

### ***Proçesi i pastrimit të karkalecave.***

Proçesi i pastrimit konsiston në heqjen nga trupi i karkalecit të pjesëve të panevojshme, si organet e tretjes, sytë sipas rastit, lëkura, etj. Mënyra e pastrimit është e lidhur ngushtë me kërkesat e konsumatorëve.

Pastrimi i tij konsiston në zhveshjen e plotë nga lëvozhga e tij duke e ruajtur tërësisht formën e trupit. Karkaleci pastrohet në prezencë të ujit, në tavolinat përkatëse të punës.

Tavolinat janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që produkti i pastruar të përfundojë në koshat plastikë përkatës, ndërsa mbetjet të grumbullohen në kazanin e mbetjeve teknologjike.

### ***Proçesi i larjes.***

Larja e karkalecave të pastruar bëhet në një makinë/pajisje të specializuar. (shiko foton përkatëse). Çdo punonjës i cili ka përfunduar sasinë respektive të karkalecave të pastruar, shkon në këtë makineri/pajisje dhe e vë atë në punë duke u kujdesur edhe për sasinë e ujit të nevojshme për kryerjen e larjes. Hidhen karkalecat mbi sitën vibruese e cila bën të mundur pastrimin e karkalecave duke i dërguar ato në koshin plastik, ndërsa uji mbledhet në enën përkatëse dhe shkon në sistemin qëndror të shkarkimit.

### ***Proçesi i marinimit.***

Produktet (karkalecat e pastruar), pasi kanë arritur maturimin janë të gatshëm për t'ju nënshtruar proçesit të marinimit, si dhe të vendosjes së tyre në enët/kovat përkatëse prej plastike të një madhësie standarte, të cilat mund të mbajnë maksimalisht 7 kg produkt. Fillimisht produkti kullohet duke larguar prej tij, lagështinë e tepërt. Më pas, produktet futen nëpër vasketa dhe u hidhet lënda marine. Kjo lëndë përgatitet në dy përzjerësa metalikë prej çeliku të pandryshkshëm. Në të bëhet përzjerja uniforme e lëndëve marine të tilla, si erëza të ndryshme piper, rigon, majdanoz, hudhra dhe vaj. Me anë të pompave të instaluar në secilin prej këtyre pajisjeve lënda marine, nëpërmjet tubacioneve shkon në tavolinën e punës ku kryhet marinimi dhe mbushja e kovave plastike.



RAPORTI TEKNIK I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.  
"ROZAFA" sh.p.k Përpunimi i karkalecit të detit".

---



*Proçesi i pastrimit të karkalecave.*



*Proçesi i larjes.*



*Proçesi i marinimit.*



*Pregatitja e lëndës marinuese.*



*Dhoma frigoriferike.*



*Kaldaja.*

### ***Proçesi i ambalazhimit.***

Pasi bëhet peshimi dhe pastrimi i kovave plastike (7 kg secila), ato kalojnë nëproçesin e mbylljes. Kovat plastike të mbylluara pastrohen mirë nga jashtë prej ujit apo njollave të vajit dhe më pas etiketohen dhe sistemohen nëpër kuti kartoni që gjithashtu mbyllen në mënyrë të sigurt.

Kutitë e kartonit me produktet brenda tyre sistemohen me kujdes në paleta prej druri dhe vendosen në zonën e caktuar në dhomën frigoriferike të ruajtjes, e cila ka një temperaturë prej +4 deri +6 °C.

### ***Proçesi i etiketimit.***

Të gjitha etiketat e produkteve përmbajnë këto tregues:

- Emrin e subjektit prodhues dhe vendndodhjen e tij.
- Emrin e artikullit bazë.
- Përbërësit (produkte të tjera që përmban kova).
- Peshën.
- Logo (që tregon datën e prodhimit dhe datën e skandencës).
- Në raste kur, produkti është për eksport, shkruhet subjekti prodhues, vendi dhe etiketat përkthehen në gjuhën angleze dhe/ose të vendit ku do të shkojë.

Në këtë linjë teknologjike përpunohen mesatarisht 2 ton/ditë karkaleca deti. Nga kjo sasi rezulton rreth 25 % mbetje teknologjike ose 0.5 ton/ditë mbetje teknologjike dhe 75 % ose 1.5 ton/ditë produkt i gatshëm.

- VI. Informacioni për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja.

Zhvillimi normal i veprimtarisë së përshkruar në kapitullin paraardhës, kërkon domosdoshmërisht edhe ndërtimin e një infrastrukture inxhinjerie, për lidhjen e këtij objekti me rrjetin elektrik, atë të furnizimit me ujë të pijshëm, të shkarkimit të ujërave të ndotura, lidhjen me rrjetin rrugor të zonës dhe atë kombëtar.

i. Furnizimi me energji elektrike

Objekti është lidhur me rrjetin energjistik të Njësisë Administrative Kodovjat, në bazë të kontratës me operatorin e shpërndarjes së energjisë elektrike të kësaj zone. Subjekti ka të instaluar një gabinë elektrike me fuqi rreth 250 kWh, me anë të sëcilës rregullon të gjithë parametrat e energjisë elektrike që shkojnë tek pajisjet e instaluara, sistemet e ndriçimit të ambienteve të brendëshme të punës, të ambienteve të jashtëm rrugë e sheshe, etj.

Godinat ku ushtrohen veprimtaritë prodhuese dhe të gjitha ambientet e tyre janë të pajisura me të gjitha pajisjet e përcaktuara në projektin elektrik të tyre duke filluar nga sasia dhe llojet e përcjellsave elektrike, pajisjet për vënien në punë dhe ndalimin nga puna të pajisjeve të ndryshme, pajisjeve ndriçuese, etj. Sistemi i shpërndarjes së rrymës elektrike ka pajisjet mbrojtëse, ato sinjalizuese, të tokëzimit si dhe pajisjet matëse të konsumit të energjisë elektrike. Fuqia elektrike e instaluar do të jetë rreth 55 kWh.

ii. Furnizimi me ujë të pijshëm.

Uji do të merret nga rrjeti përkatës i këtij rajoni që gjendet disa metra larg këtij objekti, mbështetur në kontratën respektive me subjektin që administron këtë rrjet ujësjellës. Në hyrje të objektit është instaluar pajisja matëse e konsumit të ujit. Për sigurimin e ujit pandërrerje janë vendosur dy depozita metalike me vëllim 20 m<sup>3</sup>, sejcila. Shpërndarja e ujit në pikat e përdorimit të tij është bërë nëpërmjet pompave dhe rrjetit përkatës me tuba plastike, që kalon i gjithë nëntokë. Edhe ky rrjet është i plotësuar me atrecaturat e përcaktuara në projektin përkatës të furnizimit dhe të shpërndarjes së ujit.

Në këtë aktivitet, uji nuk përdoret vetëm për plotësimin e nevojat humane të personelit punonjës prej rreth 150 personash. Uji përdoret edhe për pastrimin e produktit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar (karkalecave) dhe njëkohësisht për larjen e pajisjeve, tavolinave të punës, ambienteve të punës, etj.

Konsumi i ujit të pijshëm do të jetë rreth 25 m<sup>3</sup>/muaj.

iii. Rrjeti i kanalizimeve.

Objekti ku zhvillohet kjo veprimtari ka të ndërtuar një rrjet kanalizimesh, kunetash e pusetash që mbulojnë pothuajse të gjithë sipërfaqet objekteve si dhe ato jashtë tyre.

Në brendës të objektit ku kryhet veprimtaria prodhuese, rrjeti i kanalizimeve mbledh të gjithë ujërat që dalin gjatë pastrimit të ndërmjetëm dhe të plotë të karkalecave në përpunim, ujërat që dalin gjatë larjes së pajisjeve dhe ambienteve të punës. Ky rrjet përfundon në një kolektor kryesor i cili i shkarkon këto ujëra në sistemin e pastrimit të tij dhe në vaskën e dekantimit.



*Vaska dekantuese.*

Për shkak të pozicionit gjeografik të këtij objekti, largimi i të tre llojeve të ujërave që ne përshkruam më larg, largohen lehtësisht nga ky objekt pa ndihmën e sistemeve/pompave të nevojshme.

Vaska e dekantimitka përmasat 9 x 7 x 4.5 m dhe është e ndërtuar tërësisht me mure dhe dyshe me prej betoni. Ajo është pothuajse e mbuluar me soletë betoni mbi të cilën është hedhur një shtresë dhe, duke synuar të krijojë kështu një sipërfaqe të gjelbëruar. Kontrolli i gjendjes së saj teknike, i pastrimeve të mundëshme etj. do të bëhet me anë të dy bakabortave të mbuluara me kapakë metalikë.

#### iv. Rrjeti rrugor.

Objekti është i lidhur me rrugën automobilistike Gramsh – Kodovjat (Korçë), me anë të dy segmenteve rrugore, respektivisht në anën jugore dhe atë lindore të objektit. Të dy këto segmente rrugore kanë gjatësi 5-6 m, gjerësi mbi 5 m dhe janë të shtruar me asfalt.

VII. Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit.

Gjatë vizitës vlerësuese në linjën teknologjike të përpunimit të karkalecave të detit, konstatohet se kanë përfunduar të gjithë proceset ndërtimore për rikonstruksionin e të gjitha godinave të përcaktuara në planet ndërtimore të kësaj veprimtarie. Gjithashtu, kanë përfunduar të gjithë proceset ndërtimore për të gjitha rrjetet inxhinjrike të furnizimit me energji elektrike, ujë të pijshëm, si dhe rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza.

Po kështu, kanë përfunduar të gjitha punimet për instalimin e të gjitha makinerive e paisjeve, si dhe të gjitha ato janë vënë në shfrytëzim me kapacitet të plotë.

Është një veprimtari relativisht e re që zhvillohet në këtë rajon të vendit tonë. Subjekti "ROZAFÄ" sh.p.k. ka krijuar tashmë një përvojë të vlerësueshme në ushtrimin e këtij aktiviteti, me linja të ngjashme teknologjike në disa rajone. Ky tregues dëshmon për një punë serioze dhe të mirë menduar të këtij subjekti, gjë që jep garanci për një zhvillim afat gjatë dhe të qëndrueshëm.

Në përgjigje të kërkesave të këtij kapitulli, në vijim po pasqyrojmë disa prej drejtimeve më të mira të mundëshme, që duhen vlerësuar, analizuar dhe zbërthyer në një plan të detajuar nga drejtuesit e subjektit. Ato duhet të vlerësojnë gjithashtu edhe përcaktimet që do të përshkruhen në lejen e mjedisit, të cilat kanë lidhje me këtë kapitull.

Ndërprerja e aktivitetit të përpunimit të karkalecit të detit është një process që kryhet në mënyrë të rregullt çdo ditë (me përfundimin e orarot të punës) apo çdo fund javë dhe ditë pushimesh zyrtare. Kjo mënyrë operimi dëshmon se subjekti ka eksperiencën e mjaftueshme për të kryer të gjitha veprimet e duhura teknike, që ndërprerja të jetë pa pasoja në veprimtarinë e tij si dhe në ambjnetet e punës që ai shfrytëzon.

Sigurisht që, mbyllja përfundimtare ka kërkesa më rigorozë të cilat kërkojnë gjithashtu procedurë të përcaktuara saktësisht, për çdo stad zhvillimi të proceseve që duhen kryer për mbylljen e aktivitetit. Kështu që, kërkohen studime të plota nga grupe inxhinjerësh apo ekspertësh të fushave të ndryshme, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit financiar, mjedisor, të administrimit të teritorit, të efekteve sociale etj.

Krahas kryerjes së këtyre studimeve, duhet të përgatitet dokumentacioni përkatës për marrjen e lejeve të nevojshme, si psh vendi ku do hidhen mbeturinat që krijohen, si ato metalike, plastike gome, druri, vajrash, inertesh etj. Çdo të bëhet me truallin pas lirim të tij, do të vijojë të qëndrojë si një truall për përdorim industrial apo do përshtatet për veprimtari të tjera!?

Makineritë dhe pajisjet mund të shiten për t'u ripërdorur nga subjekte të tjera nëse vijojnë të jenë në gjendje teknike të mira ose shiten për skrap.

Ndërtesa egzistuese mund të rikonstruktohen për t'u përdorur për veprimtari të tjera ose mund të prishet me kujdes dhe materialet ndërtimore që dalin prej tyre, mund të ripërdoren diku tjetër. Organet përkatëse duhet të kenë dhënë lejet për vendin ku do të vendosen këto mbeturina të ngurta, inertesh.

VIII. Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (material ndërtimi, ujë dhe energji).

Në kapitullin paraardhës ne pohuam faktin se kanë të përfunduar të gjitha proceset ndërtimore të programuara për rikonstrksionin dhe përshtatjen për aktivitetin që do zhvillohet në godinat, hapësirat e pazëna me ndërtime, rrjeteve inxhinjerike si dhe linja me rrjetin rrugor kombëtar.

IX. Informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit.

Është e kuptueshme që një veprimtari e caktuar dhe, në rastin konkret linja teknologjike e përpunimit të karkalecit të detit, nuk mund të zhvillojë aktivitetin normal pa bashkëpunuar me veprimtari të tjera.

Kjo linjë teknologjike funksionon duke zbatuar kontratat përkatëse me furnizuesit me karkalecin dhe prodhimet e tjera të detit, me energji elektrike, ujë të pijshëm, karburante, blerësit e produkteve të prodhuar prej saj, etj. Po kështu, përdor rrjetin e shkarkimeve të ujërave të bardha e të zeza, rrjetin rrugor, subjektet që merren me largimin e mbetjeve urbane, etj.

X. Informacioni për alternativat e marra në konsideratë, përsa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret.

Duke vlerësuar kërkesën e kësaj rubrike mbi alternativën lidhur me zgjedhjen e vendndodhjes së këtij projekti, do të pohojmë se kemi një alternativë pozitive, duke ju referuar kohës së kësaj zgjedhjeje, si dhe gjendjes mjedisore, ekonomike, dhe atë të infrastrukturës së kësaj zone.

Ky vend dhe godinat në përbërje të tij, ishin pothuajse të braktisur dhe pa asnjë lloj veprimtarije. Kështu, u zgjodh dhe u shfrytëzua një truall i cili nuk kishte vlere të veçanta mjedisore, ishte plotësisht i lirë, dhe lehtësisht i shfrytëzueshëm për çdo veprimtari.

Mbi dhe nën të, nuk kishte objekte, rrjete inxhinjerike, bimësi, apo gjallesa të cilat mund të dëmtoheshin nga kjo veprimtari.

Objektet egzistuese ishin të lidhura me rrjete inxhinjerike të zonës si atë të furnizimit me energji elektrike, ujë të pijshëm, rrjeti për shkarkimin e ujërave të ndotura, etj. Gjithashtu, egzistonin mundësi të mëdha për kryerjen e punimeve ndërtimore për rikonstruksionin e godinave egzistuese, rrjeteve inxhinjerike, etj.

Trualli gjendet fare pranë dhe është i lidhur me rrugëautomobilistike kombëtare Gramsh – Kodovjat (Korçë).

Lidhur me zgjedhjen e teknologjisë që përdoret, mund të pohojmë se Subjekti "ROZAFÄ" sh.p.k i ka të gjitha kapacitete e nevojshme teknike dhe njerzore për të vlerësuar dhe zgjedhur teknologjinë e duhur. Ky subjekt ka disa vite që ushtron aktivitetin e përpunimit të peshkut dhe të prodhimeve të tjera të detit, duhe krijuar një eksperiencë të pasur në vlerësimin e proceseve teknologjike si dhe në përcaktimin e mundësive për përmirësimin e vazhdueshëm të treguesve teknikë të tyre.

XI. Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasishtë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre.

11.1. Lënda e parë.

Karkalecat vijnë në madhësi dhe lloje të ndryshme. Ka më shumë se 300 lloje të karkalecave dhe, ndërmjet tyre llojet më të njohura janë karkaleca ngjyrë kafe, rozë dhe e bardhë nga oqeani Atlantik. Këto emra të zakonshëm i referohen ngjyrës së përgjithshme të karkalecit para gatimit.

Karkalecat klasifikohen normalisht sipas madhësisë dhe numërimit, që do të thotë numrin mesatar të karkalecave për të bërë një peshë në kilogram. Sa më i madh numri, aq më i vogël janë karkalecat.

Karkalecat e freskët nuk duhet të jenë të qullët, por të fortë. Ato nuk duhet të kenë njolla të zeza që janë thjesht shenja të prishjes së tij. Lëkura e karkalecit nuk duhet të jetë e verdhë ose ranore që tregon se ato janë pastruar me bisulfate sodiumi. Aroma është një tjetër tregues i freskisë. Karkalecat e cilësisë së lartë mbajnë aromën e ujit të kripur. Nëse kanë qëndruar të hapur për shumë kohë, atëherë karkalecat do të kenë një aromë amoniaku.

Karkalecat kanë kaluar prej kohësh nga niveli i shijshëm, i disponueshëm vetëm për disa, në një produkt përgjithësisht të disponueshëm. Të ngrirë, të ftohur, të qëruar, në një guaskë - të gjitha këto lloje të produkteve mund të shihen sot në pothuajse çdo dyqan. Në të njëjtën kohë, përfitimet e karkalecave janë mjaft të krahasueshme me përfitimet e karavidheve ekzotike dhe të shtrenjta, karavidheve, gaforreve, etj.

Përsa i perket vlerave shëndetësore fantastike të tyre, madhësia nuk ka aspak rëndësi, sidomos në rastin e karkalecave të detit. E për këtë arsye, por edhe falë freskisë së tyre, ato renditen në 10 ushqimet më të konsumuara.

Karkalecat, si të gjitha shijet e detit, janë një depo me proteina të vlefshme. Përqendrimi i mikro- dhe makroelementeve të dobishëm në karkaleca është dhjetë herë më i lartë se në mish. Pra, karkalecat përmbajnë natrium, kalium, fosfor, sqfur, kalcium, magnez, hekur, zink, bakër, mangan, jod, fluor, krom, kobalt, nikel, molibden, etj. Kjo gjysmë e mirë e tabelës periodike ngop trupin tonë me një furnizim të madh të energjisë jetësore. Për më tepër, secili karkalec është një kompleks i vërtetë me multivitamina. Karkalecat e detit përmbajnë një game të gjerë vitaminash, si vitamina E, C, PP, B 1, B 2, B 3, B 6, B 9, B 12, A, D dhe H.

#### 11.2. Furnizimi me ujë të pijshëm.

Uji do të merret nga rrjeti përkatës i këtij rajoni që gjendet disa metra larg këtij objekti, mbështetur në kontratën respektive me subjektin që administron këtë rrjet ujësjellës. Në hyrje të objektit është instaluar pajisja matëse e konsumit të ujit. Për sigurimin e ujit pandërrerje janë vendosur dy depozita metalike me vëllim 20 m<sup>3</sup>, secila. Shpërndarja e ujit në pikat e përdorimit të tij është bërë nëpërmjet pompave dhe rrjetit përkatës me tuba plastike, që kalon i gjithë nëntokë. Edhe ky rrjet është i plotësuar me atrecaturat e përcaktuara në projektin përkatës të furnizimit dhe të shpërndarjes së ujit.

Në këtë aktivitet uji nuk përdoret vetëm për plotësimin e nevojave humane të personelit punonjës prej rreth 150 personash. Uji përdoret edhe për pastrimin e produktit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar (karkalecave) dhe njëkohësisht për larjen e pajisjeve, tavolinave të punës, ambienteve të punës, etj.

Konsumi i ujit të pijshëm do të jetë rreth 25 m<sup>3</sup>/muaj.

#### 11.3. Furnizimi me energji elektrike.

Objekti është i lidhur me rrjetin energjistik të Njesisë Administrative Kodovjat, në bazë të kontratës me operatorin e shpërndarjes së energjisë elektrike të kësaj zone. Subjekti ka të instaluar një gabinë elektrike me fuqi 250 kWh, me anë të së cilës rregullon të gjithë parametrat e energjisë elektrike që shkojnë tek pajisjet e instaluara, sistemet e ndriçimit të ambienteve të brendëshme të punës, të ambienteve të jashtëm rrugë e sheshe, etj.

Godinat ku ushtrohen veprimtaritë prodhuese dhe të gjitha ambientet e tyre janë të pajisura me të gjitha pajisjet e përcaktuara në projektin elektrik të tyre duke filluar nga sasia dhe llojet e përcjellsave elektrikë, pajisjet për vënien në punë dhe ndalimin nga puna të pajisjeve të ndryshme, pajisjeve ndriçuese, etj. Sistemi i shpërndarjes së rrymës elektrike ka pajisjet mbrojtëse, ato sinjalizuese, të tokëzimit, si dhe pajisjet matëse të konsumit të energjisë elektrike. Fuqia elektrike e instaluar do të jetë rreth 55 kWh.



#### 11.4. G.L.N.



Gazi i lëngëzuar i naftës (G.L.N.) është lëndë djegëse që përdoret në kaldajën e instaluar në këtë veprimtari, për ngrohjen e ujit. G.L.N. vjen me automjetet e përshtashëm për mbajtjen dhe transportin e tyre dhe depozitohet në rezervuarin që shihet në foton përbri. Vendorsja e rezervuarit është bërë sipas projektit përkatës duke respektuar distancat ligjore nga godinat dhe objektet

e tjera të kësaj veprimtarie. Po kështu, rezervuari i G.L.N. është i plotësuar me të gjitha atrecaturat e nevojshme për të kryer funksionin e tij teknologjik, si dhe për të garantuar kushtet e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes nga zjarri. Subjekti konsumon rreth 2 m<sup>3</sup>/muaj G.L.N.

#### 11.5. Karburant.

Subjekti konsumon rreth 400 litra/muaj naftë për mjetet e tij të transportit, në shërbim të kësaj veprimtarie. Me këto mjete mbulohet transporti i punonjësve 150 punëtorë, si dhe transporti i lëndës së parë, produkti, mbetjeve të ngurta teknologjike, etj.

### XII. Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.

Vlerësohet se nuk është e nevojshme ndërmarrja e aktiviteteve të përcaktuara në këtë rubrikë. Për punëtorët që punojnë në këtë linjë teknologjike, subjekti ka vënë dy autobuzë të cilët kryejnë transportin e tyre, nga qendrat e banuara në objektin ku punojnë.

### XIII. Informacioni për lejet, autorizimet dhe liçencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/liçencimin e projektit.

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me emër subjekti "ROZAFÄ" sh.p.k. është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB) me datë 05.01.2006.

Gjatë kësaj periudhe gati 15 vjeçare drejtuesit ligjor dhe ato teknike të subjektit janë kujdesur dhe kanë marrë një numur të mjaftueshëm leish/liçencash, në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës, të veprimtarisë që ushtron subjekti. Në faqen zyrtare të QKL gjen të gjitha llojet e lejeve/liçencave që dispon subjekti.

Pregatitja e këtij dokumenti është bërë me qëllim marrjen e lejes së mjedisit, për aktivitetin e ushtruar në Bashkinë Gramsh.

- XIV. Kopje të lejeve, autorizimeve dhe liçencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/liçencimin e projektit.

Bashkangjitur keni të gjitha autorizimet dhe lejet e kërkuara nga ky kapitull.